

Zyra për Shërbimet e Mbështetjes Financiare për Fëmijën në qytetin e Nju-Jorkut (New York City Office of Child Support Services, OCSS) Programet për të asistuar prindërit jokujdestarë

Zyra e Shërbimeve të Mbështetjes Financiare për Fëmijën (OCSS) e Administratës së Burimeve Njerëzore (HRA) të qytetit të Nju-Jorkut është një program federal, detyra e të cilit është të mbështesë fëmijët. OCSS-ja nxjerr mijëra fëmijë nga varfëria dhe krenohet me programet e shumta të disponueshme për prindërit.

PROGRAMET E REDUKTIMIT TË BORXHIT

OCSS-ja e ka të qartë se borxhi nga çfarëdolloj burimi mund të ketë një ndikim negativ në shëndetin mendor dhe fizik të individit. Kërkimet tregojnë se borxhi mund të ndikojë gjithashtu tek e gjithë familja. Përmes programeve të reduktimit të borxhit, OCSS-ja mund të reduktojë detyrimet e prapambetura (borxhi) të përhershme ndaj Departamentit të Shërbimeve Sociale (DSS) të qytetit të Nju-Jorkut. Që nga viti 2009, OCSS-ja ka reduktuar me afërsisht \$274 milionë shumën e borxheve të detyruara ndaj Departamentit të Shërbimeve Shoqërore të qytetit të Nju-Jorkut (DSS) përmes programeve të mëposhtme.

Vizitoni faqen <https://nyc.gov/ocss-debt-reduction> për të mësuar më shumë rreth programeve dhe për të aksesuar formularë dhe fletushka të përkthyer. Nëse keni pyetje, dërgoni një email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me subjekt “debt reduction” (reduktim i detyrimeve). Përfshini emrin tuaj të plotë, ID-në e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën dhe datën e lindjes.



- Detyrime të prapambetura deri në 500 dollarë kur prindi jokujdestar (NCP) fiton të ardhura të barabarta ose më të ulëta se niveli federal i varfërisë.
- Shkarkoni aplikacionin anglisht në <https://bit.ly/ArrearsCapApp> ose merrni aplikacionin celular në <https://nyc.gov/childsupportmobile>.



- \$5,000 kredit vjetor kur mbështetja financiare për fëmijën paguhet e plotë për një vit. Merrni deri në \$15,000 kredit gjatë 3 viteve, ose deri në shumën e borxhit që i detyroheni DSS-së..
- Shkarkoni aplikacionin anglisht në <https://bit.ly/ArrearsCreditApp> ose merrni aplikacionin celular në <https://nyc.gov/childsupportmobile>.



- Reduktoni deri në \$7,500 detyrimet e prapambetura ndaj DSS-së duke përfunduar një program rehabilitimi për përdorimin e substancave ose duke filluar dhe mbajtur një punë të re përmes programit të punësimit të DSS-së.



- Bëni një pagesë – reduktoni borxhin që i detyroheni DSS-së në vlerën e dyfishit të pagesës.
- Paguani principalin e parave të përcaktuara nga gjykata për llogari të DSS-së së qytetit të Nju-Jorkut dhe interesi juaj do të hiqet.
- Mësoni më shumë në faqen <http://nyc.gov/payitoff>.

SHËRBIMET E NDËRMJETËSIMIT

Ndërmjetësuesit janë trajnuar për të dëgjuar, për të qenë të drejtë dhe për ta mbajtur bisedën të sigurt dhe produktive. Ndërmjetësuesit ndihmojnë me:



- Pagesat e prapambetura të mbështetjes financiare për fëmijën që duhet t'i paguhet prindit kujdestar
 - Komunikimin lidhur me problemet e prindërimit
 - Pagesat e ardhshme të mbështetjes financiare për fëmijën
 - Kujdestarinë ose vizitat
 - Marrëveshjet e mbështetjes financiare për fëmijën
 - Lloje të tjera konfliktesh
- Mësoni më shumë në <https://bit.ly/MediationBrochure> ose dërgoni një email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me subjekt “Mediation”.

Shërbimet e punësimit

OCSS ka lidhur partneritet me ofruesit e punësimit për t'u ofruar prindërve jokujdestarë (NCP) akses në shërbimet e punësimit.



- Lidh NCP-të me programet dhe shërbimet e punësimit.
- Mësoni më shumë në www.courtinnovation.org/programs/parent-support-program.

SHËRBIMET E TRAJNIMIT PËR PUNË

- Trajnime falas për punë për NCP-të që kanë një çështje të mbështetjes financiare për fëmijën në qytetin e Nju-Jorkut.
- Trajnimet janë të disponueshme për sektorët e ndërtimit, transportit, TI-së dhe të mbështetjes shëndetësore.
- Telefononi në numrin (929) 221-5015 ose dërgoni email në adresën OCSS.Employment@dfa.state.ny.us. Përfshini emrin tuaj, ID-në e çështjes së mbështetjes financiare për fëmijën ose datën e lindjes.



- Program i mirënjohur punësimi për banorët e strehimeve publike të qytetit të Nju-Jorkut.
- Ofron shërbime të tilla si gatishmëri në punë, trajnim dhe asistencë për kërkimin e punës.
- Mësoni më shumë në opportunitynychua.org/workforce-development/jobs-plus/.



- Lidh NCP-të me vendet e punës në çdo sektor në të pesta lagjet.
- Përfiton falas trajnim për punë, asistencë për gjetjen e punës dhe përgatitje për intervistën.
- Mësoni më shumë në www1.nyc.gov/site/sbs/careers/virtual-wf1cc.page.



- Dërgon informacion për vendet e reja të punës drejtpërdrejt në celularët e punëkërkuësve.
- Sektorët përfshijnë kujdesin shëndetësor, shitjen me pakicë, sigurinë, transportin, arsimin etj.
- Dërgoni një mesazh me tekst "Jobs" në numrin 877877 për të marrë njoftime pune ose regjistrohuni në www1.nyc.gov/site/businesslink/contact/txt-2-work.page.

Marrëveshjet për modifikimin e urdhrave

NCP-të mund të marrin ndihmë për modifikimin e një urdhri gjykate për mbështetjen financiare për fëmijën falë asistencës së një pjesëtari të stafit të shërbimit të klientit të OCSS-së. Mësoni më shumë duke dërguar një email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us me subjekt "Agreement" ose mësoni më shumë në <https://bit.ly/changeyourorder>.



- Qasje mbështetëse dhe miqësore në modifikimin e urdhrat të mbështetjes financiare për fëmijën.
- Projektuar për të shkurtuar kohën në krahasim me procesin e zakonshëm gjyqësor. Gjithsesi, është e nevojshme një seancë dëgjimore për të marrë një urdhër me pëlqim nga të dyja palët.
- OCSS-ja ndihmon NCP-të të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar.
- Prindi kujdestar duhet të marrë pjesë nëse nuk është duke marrë ndihmë ekonomike.

Burimet shtesë

Më poshtë jepen disa burime shtesë që OCSS-ja dëshiron të sjellë në vëmendje për NCP-të.

- Mënyrat e pagesës së mbështetjes financiare për fëmijën: <https://on.nyc.gov/paymentmethods>
- Krediti i të ardhurave të fituara nga prindi jokujdestar (EITC): www.tax.ny.gov/pit/credits/nceic.htm
- Kujdestaria, vizitat dhe mbështetja financiare për fëmijën: <https://nyc.gov/hra/ocss>
- Aplikacioni celular për mbështetjen financiare për fëmijën: <https://nyc.gov/childsupportmobile>
- "Video udhëzuese" për mbështetjen financiare për fëmijën: <https://bit.ly/OCSSYouTube>
- ACCESS HRA: <https://nyc.gov/accesshra>
- ACCESS NYC: <https://access.nyc.gov>



Aplikacioni celular për mbështetjen financiare për fëmijën

Formularë dixhitalë që mund të plotësohen dhe dorëzohen thjesht duke klikuar një buton, përditësoni informacionin e kontaktit, aplikoni për programet e reduktimit të borxhit etj. nyc.gov/childsupportmobile

Mësoni më shumë sot në <https://nyc.gov/hra/ocss> ose na dërgoni email në adresën dcse.cseweb@dfa.state.ny.us (përfshini emrin tuaj të plotë, ID-në e çështjes dhe datën e lindjes).